

Statistikat e Peshkimit 2024

Tiranë, më 25 Qershor 2025: Në vitin 2024, sasia e peshkut të zënë nga të gjitha kategoritë ujore ishte 16.452 tonë, duke shënuar një rënie prej 14,9%, krahasuar me një vit më parë që ishte 19.338 tonë. Gjatë vitit 2024, u prodhuan dhe u hodhën në liqenin e Ohrit 1,2 milionë rasate të Troftës Ylber, 1,8 milionë rasate të Koranit dhe 0,8 milionë rasate Krap.

Struktura e zënieve nga peshkimi sipas kategorive

- Akuakultura përbën 43,6% (7.165 tonë)
- Ujërat e brendshme zënë 27,4% (4.505 tonë)
- Peshkimi detar përfaqëson 23,5% (3.869 tonë)

Ndryshimet vjetore të zënieve sipas kategorive ujore

- Molusqe: rritja më e madhe me +14,5%, (nga 186 tonë në vitin 2023 në 213 tonë në 2024)
- Laguna: rënie me -33,0%, (nga 218 tonë në vitin 2023 në 146 tonë në 2024)
- Akuakulturë: rënie me -21,6%, (nga 9.141 tonë në vitin 2023 në 7.165 tonë në 2024)
- Bregdet: rënie me -18,1%, (nga 676 tonë në vitin 2023 në 554 tonë në 2024)

Zëniat sipas specieve kryesore

Në det, bregdet dhe lagunë:

- Karkaleci i thellësisë: 19,5% (891 tonë)
- Merluc: 16,1% (735 tonë)
- Sardele: 12,0% (549 tonë)

Në ujërat e brendshme:

- Karas: 36,1% (1.626 tonë)
- Skortë: 33,9% (1.528 tonë)
- Krap: 10,0% (430 tonë)

Flota detare

Në vitin 2024, janë të licencuara 833 subjekte për aktivitet peshkimi, 22 subjekte më shumë se në vitin 2023. Flota operon kryesisht në Nën-Zonën Gjeografike 18 (Adriatiku i Jugut).

Sipas porteve:

- Durrës: 36,5% e anijeve të licencuara
- Vlorë: 30,7%
- Lushnje-Fier: 2,2%
- Himarë: 1,6%

Sipas llojit të anijeve:

- Anije me njica: 72,6%
- Anije me tërheqje (fundore/pelagjike): 23,9%

Metodologjia

Statistikat e peshkimit për vitin 2024, mbështeten në informacionin administrativ, të mbledhur nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Mbledhja, përpunimi dhe publikimi i tyre mbështetet në legjislacionin vendas si dhe duke zbatuar klasifikimet dhe përkufizimet sipas rregulloreve përkatëse të BE-së:

- Ligj Nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”;
- Ligj Nr. 30/2022 “Për miratimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2022 – 2026”;
- Regullorja (EC) Nr. 216/2009 mbi “Statistikat e Zënieve të Peshkut, për peshkimin në zona të caktuar përveç Atlantikut të Veriut”;
- Regullorja (EC) Nr. 762/2008 mbi “Statistikat e Akuakulturës”.

Informacioni statistikor lidhur me peshkimin dhe akuakulturën grumbullohet nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural duke u mbështetur në metodikën e GFCM (General Fisheries Commission for the Mediterranean) për grumbullimin e të dhënave bazuar në segmentet e flotës së peshkimit, grumbullimin e logbook-eve nga anijet, intervistat me operatorët e akuakulturës, etj. Të dhënat për zënien e peshkut grumbullohen sipas kategorive ujore dhe në nivel vendi.

Variablat kryesore grupohen në këto kategori:

- *Zënie peshku sipas kategorive ujore:*
 - a. Detar;
 - b. Bregdet;
 - c. Laguna;
 - d. Ujëra të brendshme;
 - e. Akuakultura;
 - f. Molusqe.
- *Zëniet sipas specieve kryesore:*
 - a. Açuga;
 - b. Karkalec i thellësisë;
 - c. Merluc;
 - d. Sardele;
 - e. Etj.

- *Flota detare sipas porteve të peshkimit:*
 - a. Durrës;
 - b. Vlorë;
 - c. Saranda;
 - d. Shëngjin;
 - e. Himara;
 - f. Lushnje –Fier.

- *Flota Detare sipas llojt të anijes:*
 - a. Me tërheqje (fundore dhe pelagjike);
 - b. Me mrezha;
 - c. Me koshilok;
 - d. Me draga hidraulike;
 - e. Me njëca;
 - f. Anije shumëpërdorimshe.

Përkufizime:**Peshkimi**

Të dhënat zënie peshku (prodhim peshku dhe akuakultura) grumbullohen sipas kategorive ujore.

Kategoritë ujore të peshkimit janë: peshkimi detar, bregdet, laguna, ujëra të brendshme, akuakulturë dhe molusqe.

Peshkimi detar: Përfshin të gjitha të dhënat e aktivitetit të flotës së peshkimit dhe kapacitetin prodhues të sipërfaqeve të ndryshme të peshkimit.

Kapaciteti i peshkimit

Është sasia e peshkut që mund të merret nga një njësi peshkimi.

Zënie peshku

Të dhënat i referohen sasisë së zënies të të gjitha llojeve të specieve detare (të peshkut, krustance, molusqe etj), specieve të ujërave të ëmbla (lumenj, liqene, ujëmbledhësa, akuakulturë).

Akuakultura

Është rritja e peshkut në kushte artificiale, në të cilin përfshihen: rritje peshku me anë të rasateve, molusqe dhe krustance

Flota

Është numri total i anijeve të peshkimit që shfrytëzon një burim të caktuar. Flota vepron pothuajse plotësisht në Nën-Zonën Gjeografike (NZGJ) 18 (Adriatiku i Jugut).

Flota detare shqiptare nisur nga qëllimi i anijes ndahet në gjashtë lloje të ndryshme anije peshkimi:

Me tërheqje (fundore dhe pelagjike) - metoda e peshkimit më e rëndësishme dhe një nga më efikaset në botë është ajo me tërheqje. Kjo metodë kryhet si në ujëra të cekëta dhe deri në thellësi 2000 m. Rrjetat tërheqëse përdoren për peshkim fundor dhe pelagjik, në varësi të formës së rrjetës të përdorur. Procesi i tërheqjes kryhet për një periudhë të caktuar kohe dhe për një distancë të caktuar, deri në tërheqjen e rrjetës lart dhe zbrazjen e saj. Ky mjet peshkimi përdoret kryesisht për të peshkuar peshqit fundorë.

Me mrezha - Këto anije përdorin rrjeta rrethuese dhe detare dhe përbëjnë një grup të madh të të gjitha madhësive, duke filluar nga anije të hapura, zakonisht të paktën 10 m në gjatësi, deri tek anijet që shkojnë në oqean. Këto zakonisht përdoren për të kapur speciet pelagjike të grumbulluara.

Me koshilok - Përbëjnë një grup anijesh duke përfshirë mjete me të gjitha madhësitë, duke filluar nga varka të vogla deri tek anijet që peshkojnë në oqean. Koshilokët janë mjetet më të rëndësishme dhe më efektive për të zënë specie që grumbullohen pranë sipërfaqes. Mjeti rrethon tufën në anë të rrjetës, më pas pjesa e poshtme e saj mbyllet (nën tufë) me anë të një litari, i cili nisët nga anija, kalon përmes unazave në fund të rrjetës dhe përsëri në anije.

Me draga hidraulike - Dragat janë mjete që gërryejnë fundin e detit për molusqe bivalvë. Dragat përbëhen nga një konstrukt metalik në të cilin kapet thesi i ndërtuar nga unaza metalike ose rrjetë. Dragat mund të tërhiqen me anije ose me krahë. Dragat janë mjete që përdoren në bregdetin e afërt dhe peshkojnë duke qenë në kontakt të fortë me tabanin.

Me njica - Madhësia e anijeve ndryshon në lidhje me zonën e gjuetisë. Këto mjete mund të jenë nga varka të vogla për ujërat e brendshme dhe në bregdet, anije të vogla në kuvertë në ujërat bregdetare dhe anije të mesme që peshkojnë në det të hapur. Në ujërat bregdetare është shumë e zakonshme që kjo formë peshkimii të përdoret si një metodë sekondare sipas sezonit të peshkimit dhe specieve target.

Anije shumëpërdorimshe - mjete peshkimi të cilat përdorin në mënyrë të alternuar dy ose më shumë vegla peshkimi pa modifikime të mëdha në anije.